

# Pyetje për ofruesin e punësimit

Konsideroni përdorimin e këtij dokumenti për t'ju udhëzuar në bisedat me një ofrues punësimi. Ju lutemi keni parasysh se ka shumë faktorë që ju ndikojnë në rrjedhën kohore të shërbimeve. Mbani mend, përvoja e secilit është unike.

## Vlerat

- Cila është gjëja më e rëndësishme që duhet të di për agjencinë tuaj?
- Si do të siguroheni që procesi për kërkim pune është hartuar për mua/nevojat e mia?
- Si do të mësoni për zotësitë, interesat dhe aftësitë e mia?
- Nëse dëshironi të përfshini në jetën time të tjerë që më njohin më mirë, si do t'i përfshini në proces?

## Cilësia e shërbimit

- Sa vetë keni punësuar në personel në ekipin tuaj të shërbimit të punësimit?
- Më tregoni për personelin tuaj – sa kohë ka që e bëjnë këtë punë?
- A keni listë pritje për shërbimet?
- A punoni me Drejtorinë e Pensilvanisë për Rehabilitim Profesional (OVR), Drejtorinë e Pensilvanisë për Programe Zhvillimore (ODP), heqje dorë nga Medicaid, Biletë për Punë, ose burime të tjera për financim?
- Me cilat industri ka përvojë agjencia juaj (me kujdesin shëndetësor, shitje me pakicë, zyra, etj.)?
- Nëse kam nevojë për masa përshtatëse në punë, si do të më ndihmoni?

## Kërkim pune

- Si do ta nisni procesin e kërkimit për punë me mua?
- Si do të më ndihmoni të gjej punën që i përshtatet më mirë jetës sime?
- Si do të më ndihmoni të planifikoj udhëtimin për në punë?
  - Do të më mësoni si të shkoj në punë dhe të kthehem nga puna?
  - Do të më mësoni se çfarë të bëj nëse linja e udhëtimit nuk është e disponueshme?
- Si do të më ndihmoni të kuptoj se si ndihmat e mia (Të ardhura suplementare nga sigurimet (SSI) ose Sigurimet Shoqërore për Sigurim për Aftësi të Kufizuara (SSDI)) mund të ndikohen?
  - Kush do të më ndihmojë t'i kuptoj përfitimet e mia dhe a e kanë certifikimin për ta ofruar këtë informacion?
- Çfarë punësh të tjera interesante ose krijuese keni mbushur?

## Përkrahje në punë

- Ç'lloj përkrahje mund të pres gjatë zhvillimit të punës dhe brenda punës nga ju?
- Si do të më ndihmoni nëse kam nevojë për pajisje të veçanta për të qenë më i pavarur në punë? (pra një program kompjuterik, tastierë, libra me figura, sistem me kode me ngjyra, etj.)
- Për sa kohë do të më përkrahë një trajner në punë?

## Rezultatet

- Sa individë keni përkrahur për të gjetur punë në vitin e kaluar?
- Sa punë ka gjetur agjencia në vitin e kaluar?
- Sa është rroga mesatare e individëve të përkrahur nga agjencia juaj?
- Për sa i përket individëve që përkrahni, sa kohë e zgjasin në punët e tyre?
- Si i ndihmoni ata që përkrahni të bëjnë përpara në karrierat e tyre?

## LE T'Ë VIHEMI PUNËS!

Për më shumë informacion, vizitoni [philaonthejob.org](http://philaonthejob.org)

foto: Steve Weinik